# Infrastrukture

| Data | Premtimi | Linku | Screenshot |
|---|---|---|---|
| 12/5/2023 | Aeroporti, Skipista, Stadiumi dhe Poli i Jugut janë projektet tona të mëdha që do të nxisin turizmin e sportit, natyrës dhe aventurës. | |  |
| 11/5/2023 | Një Resort Dimëror fantastik së bashku me Skipistën do i shtohen Korçës si një vlerë e jashtëzakonshme për turizmin dhe sportet dimërore. Ndërtimi i tyre në një nga zonat më të bukura malore të Korçës do të jetë një potencial për turizmin rajonal dimëror dhe do të ndikojë në zhvillimin e zonës dhe rritjen e të ardhurave nga ky sektor. | |  |

<table>
<tr>
<td>10/5/2023</td>
<td>Kemi projektuar në mandatin e ardhshëm edhe krijimin e një lagjeje të re të teknologjisë, si një mundësi e shkëlqyer banimi për të rinjtë e angazhuar në fushën e teknologjive të informacionit, si edhe shumë projekte të tjera.<br>LAGJJA E RE E TEKNOLOGJISË<br>Një lagje e re fantastike do t’i shtohet Korçës si një mundësi e shtuar për të rinjtë e angazhuar në fushën e teknologjisë me qëllim uljen e kostos së tyre të jetesës.<br>Një prej shtyllave më të forta të programit tonë në mandatin e ardhshëm është pikërisht trajnimi dhe punësimi i të rinjve në fushën e teknologjisë.</td>
<td></td>
<td>
</td>
</tr>
<tr>
<td>10/5/2023</td>
<td>POLI I JUGUT Prezantimi i një prej projekteve më të rëndësishëm në mandatin tonë të ardhshëm, Poli i Jugut Drenovë-Boboshticë-Qatrom. Një projekt madhor që do të sjellë mundësi zhvillimi në bujqësi, turizëm, ekonomi dhe do ta kthejë Korçën në faktor të rëndësishëm për zhvillimin rajonal.</td>
<td></td>
<td>
</td>
</tr>
<tr>
<td>9/5/2023</td>
<td>AEROPORTI TURISTIK DHE SPORTIV<br>Aeroporti Turistik dhe Sportiv i Korçës do të jetë një vlerë e jashtëzakonshme për turizmin në Korçë.<br>Ndërtimi i Aeroportit së shpejti do të jetë një realitet i prekshëm që do t’i japë një shtysë të madhe zhvillimit të turizmit rajonal dhe sporteve të aventurës.</td>
<td></td>
<td>
</td>
</tr>
</table>

| | | | |
|---|---|---|---|
| 7/5/2023 | ?TERMOIZOLIMI I BANESAVE KOLEKTIVE në Korçë është një projekt tashmë i filluar nga bashkia.<br>Deri tani:<br>? 259 FAMILJE janë përfituese të këtij projekti<br>? 12 PALLATE kanë përfunduar në 4 lagje të qytetit të Korçës<br>? 15 PALLATE të tjera do të fillojnë së shpejti | |  |
| 3/5/2023 | TERMOIZOLIMI I PALLATEVE Brenda 4 vitesh do të përfundojmë punën e nisur për termoizolimin e të gjitha banesave kolektive në Korçë. | |  |

---

Revision #1
Created 2023-09-20 12:46:27 UTC by P. P
Updated 2023-09-20 12:49:50 UTC by P. P